



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2020:042658

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05523048

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditësve - kundër të paditurve, S. B. dhe Xh. B. , që të dy nga fshati ..., Komuna Hani i Elezit, të cilët me autorizim i përfaqëson F. Sh. avokat nga Ferizaj kundër të paditurit-kundër paditësit Rr. B. nga fshati ..., Komuna Hani i Elezit, të cilin me autorizim e përfaqëson M. K.-B. avokate nga Kaçaniku, për çështjen kontestuese uzurpim i pronës së paluajtshme dhe vërtetim pronësie në shqyrtim kryesor dhe publik të mbajtur më datës 05.03.2024, në prezencën e paditësve - kundër të paditurve dhe të autorizuarit e tij, në prezencën e të paditurit dhe të autorizuarit të tij, ndërsa me datën. 29.03.2024 bëri përpilimin me shkrim të këtij:

**A K T G J Y K I**

I. REFUZOHET, në tersi si e pa bazuar, kërkesëpadia e paditësve-kundër të paditurve S. B. dhe Xh. B. nga fshati ..., e ushtruar më datën 22.11.2013, kundër të paditurit-kundër paditësit Rr. B., me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet uzurpimi i një pjese të njësisë kadastrale edhe atë: Pk.nr. ..., në sipërfaqe prej 45m<sup>2</sup>, njësisë Pk.nr....., në sipërfaqe prej 27 m<sup>2</sup>, të cilat evidentohen në emër të Xh. B. dhe njësisë kadastrale ..., në sipërfaqe prej 87 m<sup>2</sup>, të cilat evidentohet në emër të S. B. nga fshati ..., Komuna Hani i Elezit.

II. MIRATOHET, në tërësi si e bazuar, kundërpadia e të paditurit-kundër paditësit dhe VËRTETOHET se i padituri-kundër paditësi Rr. B. nga fshati ..., Hani i Elezit, është pronarë i një pjese të njësisë kadastrale, ... në sipërfaqe prej 45m<sup>2</sup>, e cila përkufizohet siç vijo: në anën

perëndimore, nga pika 1 nëpër pikën 2, e deri tek pika 3, në gjatësi prej 5.80m, në anën jugore, nga pika 3, nëpër pikat 4,5,6,7 dhe 8, e deri tek pika 9, në gjatësi prej 36.53m, në anën lindore, nga pika 9 deri tek pika 20, në gjerësi prej 0.98m dhe në anën veriore nga pika 20 deri tek pika 2, në gjatësi prej 10.95m, dhe nga pika 21, përgjatë kufirit me parcelën kadastrale me nr. ..., e deri tek pika 22, në gjatësi prej 31.40m, e cila gjendet në Zonën Kadastrale ..., Komuna Hani i Elezit.

Pronarë në një pjesë të ngastrës kadastrale ..., në sipërfaqe prej 27m<sup>2</sup>, e cila përkufizohet, në anën perëndimore, nga pika 9 deri tek pika 20, në gjerësi prej 0.98m, në anën veriore nga pika 20 deri tek pika 19, në gjatësi prej 19.55m dhe nga pika 19, deri tek pika 12, në gjatësi prej 2.28m, në anën lindore, nga pika 12 deri tek pika 11, në gjerësi prej 1.63m dhe në anën jugore, nga pika 11, nëpër pikën 10, e deri tek pika 9, në gjatësi prej 21.13m, e cila gjendet në Z.K. ..., Komuna Hani i Elezit.

Pronarë, në një pjesë të njësisë kadastrale ..., në sipërfaqe prej 87m<sup>2</sup>, e cila përkufizohet, në anën jugore, nga pika 12 deri tek pika 19, në gjerësi prej 2.28m, në anën veriore, nga pika 19, nëpër pikën 18 deri tek pika 17, në gjatësi prej 60.16m, në anën lindore, nga pika 17, deri tek pika 16, në gjerësi prej 0.49m dhe në anën jugore, nga pika 18, nëpër pikat 15,14 dhe 13, e deri tek pika 12. në gjatësi prej 59.44m, këto njësi gjenden në Z.K. ..., të evidentuar në emër të paditësit-kundër të paditurit Xh. B. nga fshati ..., Hani i Elezit.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktgjykimi, është plan rilevimi i terrenit i datës. 19.11.2015, dhe 05.07.2023, ky aktgjykim do të shërbej si bazë - titull ekzekutiv për ti bërë ndryshimet kadastrale.

IV. DETYROHEN paditësit - kundër të paditurit që të paditurit – kundër paditësit të i`a paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1386.50€, e cila pagesë do të bëhet në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimimit në dorëzim të aktgjykimit të plotfuqishëm.

## A r s y e t i m

Paditësit - kundër të paditurit përmes të autorizuarit, si në padi ashtu edhe në seancat e mbajtura, i kanë propozuar gjykatës që kërkesë padinë e paditësve ta miratoj në tërësi si të bazuar.

Kanë theksuar se i padituri- kundër paditësi, e ka uzurpuar pronën e paditësve-kundër të paditurve edhe atë pjesë të ngastrave kadastrale Pk.nr. ..., në sipërfaqe prej 45m<sup>2</sup>, Pk.nr. ..., në sipërfaqe prej 27m<sup>2</sup>, pronë e (Xh. B. ) dhe ngastra Pk.nr. ..., në sipërfaqe prej 87m<sup>2</sup>, në emër të (S. B.) nga fshati ..., Hani i Elezit.

Kanë theksuar se këtë pronë pa kurrfarë baze ligjore i ka uzurpuar i padituri, i cili fakt është vërtetuar nga deklaratat e paditësve të dëgjuar në cilësinë e palës si dhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë M. S., e këto veprime i ka bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 72 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore të ish RSFJ si dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore të Republikës së Kosovës, sepse paditësit-kundër të paditurit pronësinë në pjesë të ngastrave lëndore e kanë fituar ashtu siç është paraparë me nenin 20 të shënuar më lartë.

Po ashtu i autorizuari e ka kontestuar kundërpadinë e të paditurit-kundër paditësit dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar sepse kundër paditësi e ka bërë uzurpimin e këtyre ngastrave dhe në të njëjtat nuk e ka fituar të drejtën e pronësisë sepse pronat kontestuese i ka në posedim me keqbesim.

Nga provat e administruara gjatë kësaj procedure, është vërtetuar pa mëdyshje se i padituri është posedues me keqbesim, i pjesëve të pronave, të cilat sipërfaqe kanë qenë në shfrytëzimi si rrugë , deri në momentin kur tani i padituri diku rreth vitit 1996, kur e ka ndërtuar murin dhe i ka uzurpuar pjesët të cilat janë përshkruar më lartë.

Se i padituri, është uzurpuesi i këtyre pjesëve, e qe nuk bëhet fjalë për posedim me mirë besim është vërtetuar nga dëshmi e dëshmitarëve të dëgjuar në këtë procedurë, e posaqrishtë nga deklaratat noteriale e dëshmitarit B. B., i cili ka qenë pronar i pronave objekt kontestit, e qe ja ka shitur tani paditësve.

Tutje ka sqaruar se i padituri, është në posedim me keqësim, të kësaj prone, është vërtetuar nga deklarata e dëshmitarëve E. B., S. B., G. B. dhe E. B., ku të gjithë këta kanë dëshmuar, se i padituri ka qenë në posedim me keqe besim dhe i njëjti këtë pronë e ka uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme.

Prandaj nga këto baza, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta miratoj në teri si të bazuar, sepse nga provat e administruar e në veçanti nga deklaratat e dëshmitarëve është vërtetuar se i padituri këto prona i ka uzurpuar.

I autorizuari tutje ka theksuar, se kundër padia e të paditurit duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk është e bazuar në asnjë bazë ligjore, nga e cila mundë të fitohet e drejta e pronësisë dhe nuk plotësohet asnjë nga kushtet e posedimit me mirë besim

Shpenzimet i kanë kërkuar.

E autorizuar e të paditurit-kundër paditësit si në seancat e mbajtura gjyqësore ashtu edhe në fjalën përfundimtare; i ka propozuar gjykatës që kërkesë padinë e paditësve-kundër të paditurve, ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar. Pala paditëse-kundër e paditur me asnjë provë nuk e ka dëshmuar se i padituri - kundër paditësi Rr. B. e ka bërë uzurpimin e pjesëve të këtyre ngastrave kontestuese.

Nga të gjitha provat e administruara, është vërtetuar se i padituri-kundër paditësi këtë paluajtshmëri, e ka blerë rreth viteve 1970-1971 dhe që nga ajo kohë e shfrytëzon në kufijtë e njëjtë, e i cili fakt është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë dhe plotësimi i saj si dhe sqarimet të cilat i ka bërë në këtë gjykatë

Po ashtu ka theksuar se ky fakt është vërtetuar edhe nga deklarata e paditësve-kundër të paditurve të dhënë në cilësinë e palës, në seancën e datës 29.06.2016, ku vërtetohet se i padituri-kundër paditësi, këtë pronë e ka blerë gjatë këtyre viteve, këtë paluajtshmëri e ka poseduar që nga viti 1975 e deri më tani, i pa penguar nga askush as nga paditësit - kundër të paditurit.

E autorizuar tutje ka theksuar se këto fakte vërtetohen nga dalja në vendin e ngjarjes së bashku me ekspertin e gjeodezisë dhe plotësimin e ekspertizës, ku është konstatuar se poseduesi i palujtëshmërive kontestues është i padituri, po ashtu është konstatuar se kufiri në mesë të këtyre parcelave kontestues, është kufiri i vjetër kadastral.

Po ashtu ka theksuar se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues , sepse janë plotësuar katër elementet në mënyrë komulative edhe atë: është mbajtës i ligjshëm(posedimin nuk e ka fituar me përdorimin e forcës, mashtrim apo keqpërdorim të besimit), është posedues me mirë besim( paditësi nuk e ka pasur të njohur faktin se pjesët e pronës kontestues , të cilat i shfrytëzon kanë qenë të evidentuara në emër të personit tjetre), kalimi i periudhës kohore të caktuar me ligje(periudha kohore në fillimin e posedimit llogaritet nga vitet 1970-1971, ndërsa periudhën kohore e cila duhet të kalojë për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues e parashih ligji-LMTHJP apo LPTDS), dhe elementi tjetër është se sendi mbi të cilën tjetri e ka të drejtën e pronësisë.

E autorizuar e të paditurit, i ka propozuar gjykatës, që kundër padia e të paditurit-kundër paditësit, të miratohet në tërësi si e bazuar dhe të vërtetohet se i padituri-kundër paditësi është pronarë i një pjese të ngastrave Pk.nr. ..., në sipërfaqe prej 45m<sup>2</sup>, Pk.nr. ..., në sipërfaqe prej 27m<sup>2</sup>, pronë e (Xh. B. ) dhe ngastra Pk.nr. ...,sipërfaqe prej 87m<sup>2</sup>, në emër të (S. B.), nga fshati ..., Hani i Elezit, sepse pronësinë në këtë pjesë e ka fituar me mbajtje pa e penguar askush.

Shpenzimet i ka kërkuar.

Për ta vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar drejtë këtë çështje kontestimore juridiko-civile, gjykata me propozimin e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse në procedurën e provave bëri leximin e këtyre provave të shkruara: u lexuan provat si në procesverbalin e datës 13.09.2016, ankesa e datës 17.10.2016, përgjigja në ankesë, Aktvendimi AC.nr.4179/16, plotësimi i ekspertizës i datës 06.07.2023, harta kadastrale, deklarata e datës 10.06.2022, deklaratat e dëshmitarëve: E. B., S. B. , G. B.dhe E. B., pa vërejtje

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të provave në tërësi dhe të secilës veç e veç e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të LPK-së, si dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko-civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Prona kontestuese evidentohet në emër të paditësve-kundër të paditurve, këtë pronë i padituri-kundër paditësi, e ka në posedim prej vitit 1970-1971, paditësi-kundër të paditurit që nga viti 1970-71, e kanë ditur se i padituri-kundër paditësi i ka në posedim pjesët kontestuese, në pjesët kontestuese të ngastrave i padituri-kundër paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë me mbajtje me mirëbesim.

a) Se pronat kontestuese evidentohet në emër të paditësve-kundër paditësit, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga certifikata e pronës, ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, plotësimi i ekspertizës, në të cilat prova është shënuar se njësit kadastra ... dhe ..., janë pronë e Xh. N. B., ndërsa njësia kadastrale, është pronë e S. B. nga fshati ... Komuna e Hanit të Elezit.

b) Se pronat kontestuese, i ka në posedim i padituri-kundër paditësi, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga plotësimi i ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë, i cili në plotësim ka konstatuar se i padituri-kundër paditësi Rr. B. nga fshati ..., Hani i Elezit, i ka në posedim pjesë të ngastrave kadastrale Pk.nr. ... në sipërfaqe prej 45m<sup>2</sup>, Pk.nr. ... në sipërfaqe prej 27m<sup>2</sup>, pronë e Xh. B. dhe ngastra Pk.nr. ... në sip. prej 87m<sup>2</sup> në emër të Servet Berisha, po ashtu eksperti ka konstatuar në ekspertizën e tij se se kufiri në mes të këtyre parcelave kontestuese është kufi i vjetër kadastralë dhe se këtu ka të bëjë me mospërputhje të natyrës teknike.

Po ashtu ky fakt është vërtetuar edhe nga deklaratat e paditësve-kundër të paditurve të ndëgjuar në cilësinë e pales, të cilët deklaruan se i padituri-kundër paditësi këto pronat i ka në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar prej vitit 1985 e deri më tani, po ashtu edhe nga seanca e vendshiqimit gjykata ka konstatuar se pjesë të ngastrave kadastrale të cilat janë kontestuar i ka në posedim Rr. B. nga fshati ..., Hani i Elezit.

c) Paditësit-kundër të paditurit, që nga viti 1985, e kanë ditur se këto pjesë të njësive kadastrale, janë në shfrytëzim të paditurit-kundër paditësit, këtë fakt nuk e kanë kontestuar dhe gjykata e vërtetoi nga deklaratat e paditësve-kundër të paditurit të dëgjuar në cilësinë e palës, të cilët deklaruan se prej kur është rrënuar muri me gurë dhe është ndërtuar muri me beton nga viti 1975, e kanë ditur se i padituri-kundër paditësi ka hyrë në pronën e tyre.

ç) I padituri-kundër paditësi, në këto pjesë e ka fituar të drejtën e pronësisë, sepse të njëjtat i ka në posedim me mirëbesim, që nga viti 1985 dhe nuk është penguar nga paditësit-

kundër të paditurit dhe janë plotësuar kushtet nga neni Neni 28 par 4 , me të cilën dispozitë është paraparë se mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh. Po ashtu me nenin 40 të LPDS,. Prandaj gjykata duke i pas për bazë këto fakte të konstatuar vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

d)Padiësit-kundër të paditurit, asnjëherë nuk e kanë kontestuar këtë posedim dhe nuk kanë zhvilluar asnjë procedure për lirimin e këtyre pronave, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga deklarata e dëshmitarit R. B., i cili në seancën e datës 21.07.2016, ka deklaruar se kjo rrugë me atë gjerësi ka ekzistuar prej se e mban mend që nga koha kur ka punuar në shërbimin e gjeodezisë si vërtetues dhe asnjëherë kjo pronë nuk është kontestuar as nga padiësit.

Gjykata pas analizimit të provave, padinë e padiësve-kundër të paditurve S. B. dhe Xh. B. që të dy nga fshati ..., Hani i Elezit, me të cilën kanë kërkuar lirimin e pjesëve të ngastrave kadastrale e refuzoj në tërësi si të pa bazuar. Padiësit me asnjë provë nuk e kanë vërtetuar se i padituri - kundër padiësi Rr. B., e ka bërë uzurpimin e këtyre pjesëve të ngastrave kadastrale. Pala padiëse e ka pasur të ditur faktin se i paditurit e ka ndërtuar murim me beton dhe nuk kanë marrë asnjë veprim për të ja bërë të ditur se i njëjti i ka uzurpuar këto njësi kadastrale. Nuk ka paraqitur asnjë provë , me të cilën do ta konstatonte se i njëjti e ka bërë uzurpimin e kësaj pjese, Nuk e ka filluar asnjë procedurë gjyqësore të paraparë me ligj për lirimin e këtyre pjesëve , nuk ka kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Gjykata pas analizimit të provave kundërpadinë e të paditurit-kundër padiësit e miratoj në tërësi si të bazuar dhe e vërtetoj se i padituri-kundër padiësi, e ka fituar të drejtën e pronësisë si në pikën II të këtij aktgjykimi. Këtë fakt gjykata e konstatoj nga plotësimi i ekspertizës i datës 28.06.2016 dhe 05.07.2023, në të cilën është konstatuar se i padituri Rr. (Z. ) B. nga fshati ..., Hani i Elezit, i ka në posedim pjesët e ngastrave kadastrale kontestuese po ashtu ky fakt u vërtetua edhe nga deklarata e padiësit - kundër të paditurit Xh. B. i dëgjuar në cilësinë e palës, i cili ka theksuar se i padituri që nga viti 1985 këto pjesë të ngastrave i ka në posedim, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e aprovimit të kundër padisë, si dispozita materiale ka zbatuar nenet 20 par.1, 28 par.2 lidhur me par.4, lidhur me nenin 72 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (Gaz.zyr.RSFJ.nr.6/1980). Me nenin 20 par.1 të LMTHJP si ligj në fuqi në

kohën e krijimit të marrëdhënies juridike është e rregulluar se “e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim”.

Ndërsa me nenin 21 të këtij ligji janë të rregulluara rastet se kur pronësia mund të fitohet sipas vetë ligjit, ku me këtë nen është e rregulluar se “sipas vetë ligjit e drejta e pronësisë fitohet me krijimin e sendit të ri, me bashkim, me përzjerje, me ndërtim në tokën e huaj, me ndarjen e fryteve, me parashkrimin fitues, me fitim të pronësisë nga jo-pronari, me okupim dhe në raste të tjera të caktuara me ligji”. Ndërsa me nenin 28 par. 2 “mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 10 vjetëve”, ndërsa me par.4 të të njëjtit nen, është e rregulluar se “mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri e ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”.

Ndërsa me nenin 30 par.1 ka qenë e rregulluar se “koha e nevojshme për parashkrimin fitues fillon të ec, nga ajo ditë kur mbajtësi e ka marrë në posedim sendin dhe mbaron me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme për parashkrimin fitues”.

Me nenin 72 par.1 dhe 2 të LMTHJP është e rregulluar se çfarë kuptojmë me posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim, ku në bazë të kësaj dispozite “posedimi është i ligjshëm, po që se mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike, që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë, dhe nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit”, ndërsa “posedimi është me mirëbesim po qesë mbajtësi nuk di ose nuk mund të dijë se sendi që e mban nuk është i tij”.

Gjykata e ka bërë bashkimin e lëndës C.nr.127/15, me lëndën C.nr.280/13, sepse kemi të bëjmë me palë të njëjta dhe çështje të njëjtë, ndërsa procedura do të vazhdoj sipas lëndës C.nr.280/13, sepse kjo lëndë ka ardhur më herët ë gjykatë, bashkimi i lëndëve është bërë konform nenit 408 të LPK-së.

Gjykata i analizoj theksimet e të autorizuarit të paditësve-kundër të paditurve të cilët i propozuan gjykatës që ta miratoj kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurin-kundër paditësin që ta bëjë lirimin e pronës së uzurpuar, por këto theksime gjykata nuk i morri për bazë me rastin e vendosjes, sepse paditësit-kundër të paditurit me asnjë provë nuk e kanë vërtetuar se i padituri-kundër paditësi ka bërë uzurpimin e pronës kontestuese.



Gjykata në veçanti e ka analizuar, pretendimin e paditësve, se nga deklarata e datës 10.06.2024, e dhen nga B. B. dhe deklarata e dëshmitarëve tjerë , të dëgjuar gjatë këtij procesi gjyqësor, është vërtetuar fakti , se kjo pasuri është uzurpuar. Këto pretendime gjykata nuk i mori për bazë me rastin e vendosje, sepse këto deklarata të dëshmitarëve, nuk ishin reale dhe vetëm bazohen në atë çka kanë dëgjuar. Dëshmitari B. B. në deklaratë me shkrim, ka deklaruar se parcelat me numër 0321-0,ka sipërfaqe prej 45m2, 0322-0, ka sipërfaqe prej 27m2, pra ky dëshmitar nuk e din as ë sipërfaqes e njëjësive kadastrale, dhe kjo deklaratë është hartuar sipas dëshirës së paditësve e jo qe e din gjendjen faktike. Po ashtu gjykata i ka analizuar edhe deklaratat e dëshmitarëve, të dhëna në seancën e datën 16.01.2024, por këto deklarata nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes, sepse dëshmitarët kanë deklaruar se kanë dëgjuar, por nuk e din se ku është prona, kush e shfrytëzon etj, të gjithë këto dëshmitar jetoj në Republikën e Maqedonisë Veriore.

Gjykata i analizoj edhe pretendimet e të paditurit-kundër paditësit, i cili i propozoj gjykatës që padinë e paditësve-kundër të paditurve ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar, këto theksime gjykata i mori për bazë me rastin e vendosjes, sepse paditësit me asnjë provë nuk e kanë vërtetuar se i padituri - kundër paditësi e ka bërë uzurpimin e pronës së paditësve.

Gjykata po ashtu i analizoj edhe pretendimet e të paditurit-kundër paditësit, i cili i propozoj gjykatës që kundërpadia të miratohet si e bazuar dhe të vërtetohet se kundër paditësi është pronarë i pjesëve të ngastrave kontestuese, këtyre theksimeve gjykata u a dha besimin dhe vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi.

Gjykata i detyroi paditësit-kundër të paditurit që në mënyrë solidare të ja paguaj paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1436.50€ edhe atë shumën prej 104€ për përpilimin e padisë, 1,215.00€ për 9 seanca gjyqësore të përfaqësuara nga avokati, shumën prej 67.50€ për një seancë të shtyrë, gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

Nga sa u theksuar më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

C.nr.203/2020 prej 05.03.2024

Gjyqtari:

**Riza LIVOREKA**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Dërguar me datën 29.03.2024

Paditësve 1x1

Të paditurit 1x1